

STATUTI
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
DAAZH Sh.p.k.

I. THEMELIMI

Neni 1
Ortaket themelues

- 1.1 Shoqeria DAAZH Sh.p.k themelohet nga ortaket:
1. **Z. Danjel Garunja**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 15.05.1988 banues ne Rruga Hamdi Garunja, Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr personal I80515074D.
 2. **Zj.Lesina Begvarfaj**, shtetase shqiptare, lindur ne Lezhe, me 29.08.1984 banuese ne Rr. Siri Kodra, Tirane, mbajtese e Kartes se Identitetit me nr personal I45829070K.
 3. **Alfred Muharemi**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 18.02.1991 banues ne Vaqarr, Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr personal J10218077E.
 4. **Zhylljen Sava**, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 15.01.1992 banues ne Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr personal J20115085B.
 5. **Zoje Hasanaj**, shtetase shqiptare, lindur ne Shkoder, me 20.11.1950, banuese ne Shkoder, mbajtese e Kartes se Identitetit me nr personal F06120066D.

II. EMERTIMI. SELIA. FORMA LIGJORE

Neni 2
Emertimi

- 2.1 Shoqeria emertohet **DAAZH sh.p.k.**

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k), ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare".
- 3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4
Baza ligjore



- 4.1 Shoqeria DAAZH Sh.p.k., do te kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, me këtë Statut, ligjin nr. 7638 datë 19 Nëntor 1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe dispozitat e tjera të legjislativës shqiptare.

Neni 5 Kohezgjatja

- 5.1 Veprimtaria e Shoqërisë do të fillojë pas regjistrimit në QKR.
- 5.2 Veprimtaria e shoqërisë do të zgjase për një afat kohe të pacaktuar.

Neni 6 Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën Rruga "Elbasanit" Sauk, Tiranë, Shqipëri në ambjentin me Nr. Pasurie 193/72-ND1 Zona Kadastrale 2704 Volumi 28 Faqe 188 me sipërfaqe 97.4m².
- 6.2 Selia e shoqërisë mund të ndryshojë edhe me vendim të vetë administratorit (reve) të shoqërisë, por vetëm brenda qytetit në të cilin ndodhet aktualisht.
- 6.3 Shoqëria ka të drejtë të krijojë degë, filiale ose / dhe zyrë përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë vendit.
- 6.4 Shoqëria parashikon edhe mundësinë e pjesëmarrjes në shoqëri të tjera ekzistuese ose në shoqëri që në të ardhmen do të zhvillojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 7 Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj që do të përdoret bashkërisht ose veçmas nga administratori/et.
- 7.2 Forma e vules dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

Neni 8 Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Sherbimi konsulent ligjor dhe asistencë për personat juridikë dhe fizikë në fushën civile, penale, administrative, tregtare, rregullat e prokurimeve publike dhe koncesioneve.
- Konsulencë në të drejtat e sigurimeve shoqërore, shëndetësore apo të punësimit.
- Mbrojtja e të drejtave me pasoje demshperblime në fushën e sigurimeve dhe në të gjitha format e

demshperblimit si rrjedhoje e demit te shkaktuar. Konsulence e plote ne procedurat ligjore te rregjistrimit per kompani shqiptare dhe te huaja.

-Ndertime Civile dhe industriale.

-Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi

-Agjenci imobiliare. Krijim, zhvillim, zyra ndermjetesimi per pasurite e paluajtshme nepermjet nenshkrimmit te nje kontrate te vecante Franchising, aktivitet ndermjetesimi per pasurite e paluajtshme. Aktivitet ne fushen e pasurive te patundshme, vleresimin e pasurive te patundshme, te angazhohet ne shitjen me shumice dhe pakice te cdo lloj pasurie. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Administrimin e bashkepronesise ne prona dhe ndertesa per dhenien me qira, nen qira te ambienteve te ndryshme.

8.2 Objekti i shoqerise mund te zgjerohet ose ndryshoje me vendim te Asamblesë së Ortakëve.

Neni 9 Kapitali

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 (njemije) lekë, i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht nga ortakët.

9.2 Kapitali është i ndarë në 5 (pese) kuota.

9.3 Pjesët e kapitalit zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- | | |
|---------------------|---|
| 1. Danjel Garunja | -12.5% te kapitalit themeltar, 1 kuote me vlere 125 lek |
| 2. Lesina Begvarfaj | -12.5% te kapitalit themeltar, 1 kuote me vlere 125 lek |
| 3. Alfred Muharemi | - 25% te kapitalit themeltar, 1 kuote me vlere 250 lek |
| 4. Zhyljen Sava | -25% te kapitalit themeltar, 1 kuote me vlere 250 lek |
| 5. Zoje Hasanaj | - 25% te kapitalit themeltar, 1 kuote me vlere 250 lek |

Neni 10 Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

10.1 Pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen vetem me akt noterial.

10.2 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve te shoqerise.

10.3 Pjeset e kapitalit mund tu transferohen edhe te treteve, por pasi te jete ushtruar dhe refuzuar e



drejta e parablerjes nga ortakët e shoqërisë.

- 10.4 Pjesët e kapitalit transferohen në rrugë trashëgimie pasi të jetë marrë vendimi i Asamblesë së Ortakëve lidhur me kalimin e pjesëve të kapitalit tek trashëgimtarët.

Neni 11

Zmadhimi / Zvogelimi i kapitalit themeltar

- 11.1 Ortakët mund të rrisin ose zvogelojnë pjesën e tyre në kontributin e kapitalit themeltar vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve të marre nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit themeltar por zvogelimi do të kryhet brenda kufijve të lejuar nga ligji, përndryshe shoqëria duhet të shndërrohet në një formë të re..

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 12

Asambleja e Ortakëve

- 12.1 Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimor i shoqërisë. Asambleja merr vendime me një ose disa ortakë që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.
- 12.2 Asambleja e Ortakëve drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Vendimet e Asamblesë përfshijnë kryesisht:

- ndryshimin e selisë;
- ndryshimin e emertimit të shoqërisë;
- rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar paleve të treta;
- prishjen e shoqërisë;
- likuidimin e shoqërisë;
- emerimin ose shkarkimin e administratorit / administratoreve të shoqërisë
- miratimin e bilancit të shoqërisë;
- transformimin e shoqërisë në formë të tjera.

Neni 13

Asambleja e Zakonshme

- 13.1 Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve mund të thirret në çdo kohë nga Administratori ose një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 10 për qind të pjesëve të kapitalit themeltar.
- 13.2 Një ortak mund të përfaqësohet nga një përfaqësues me prokurë. Një ortak mund të përfaqësojë vetëm njërin prej ortakëve të tjerë.

Neni 14

Asambleja e Jashtëzakonshme

- 14.1 Në mbledhjet e jashtëzakonshme vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$

e pjeseve te kapitalit themeltar.

Neni 15
Thirrja dhe zhvillimi i mbledhjeve

- 15.1 Mbledhjet zhvillohen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te njoftuar nga njeri prej administratoreve.
- 15.2 Njoftimi kryhet me shkrim, me telegram, me leter rekomande', dhe poste tjeter te regjistruar, te pakten 15 dite perpara dates se zhvillimit te mbledhjes dhe permбан daten, vendin, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.
- 15.3 Ortaket qe perfaqesojne pakicen dhe qe nuk jane te pranishem ne mbledhje edhe pse kane marre njoftim, u binden vendimeve qe merr shumica e kerkuar nga ligji.

Neni 16
Marrja e vendimeve

- 16.1.1 Vendimet merren me vota te ortakeve te pranishem personalisht ose te perfaqesuar.
- 16.1.2 Cdo vote perfaqeson pjeset e kapitalit.
- 16.2 Votat numerohen nga drejtuesi i mbledhjes i caktuar ne celjen e saj dhe regjistrohen ne Librin e Ortakeve.
- 16.3 Libri mbahet nga njeri prej administratoreve ose nje sekretar i mbledhjes qe nenshkruan se bashku me drejtuesin e mbledhjes.

Neni 17
Administrimi

- 17.1 Administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator ose nga nje grup administratoresh qe caktohen nga Asambleja e ortakeve.
- 17.2 Administratoret nuk jane detyrimisht ortake, por mund te jene edhe jo ortake.
- 17.3 Administratoret kane te drejte te perfaqesojne shoqerine dhe drejtojne punen e perditshme te shoqerise ne perputhje me udhezimet e Asamblese se Ortakeve.
- 17.4 Administratoret jane solidarisht pergjigjes per veprimtarite e meposhtme:
 - drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise;
 - perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose duke caktuar zevendesues;
 - pergatitjen e mbledhjeve te Asambleve te Ortakeve dhe plotesimin e procedurave te thirrjes se tyre;

- hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vete; emerimin e eksperteve kontabel, ne rast nevoje;
 - pergatitjen e dokumenteve ne emer te shoqerise sipas kompetencave qe kane;
 - lidhin kontrata pune dhe i zgjidhin ato sipas rastit;
 - zhvillojne veprimtari te tjera te cdo lloj natyre per te miren e shoqerise dhe realizimin e objektit te shoqerise.
- 17.5 Shoqeria do te administrohet nga nje administrator, zj. Mariela Kita me numer personal J65218038W, mandati i te ciles do te jete deri ne castin e revokimit te saj me vendim te shumices se ortakeve, per cdo lloj arsyeje.

Neni 18 Viti financiar

- 18.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar ne 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor.
- 18.2 Si perjashtim, viti i pare i veprimtarise se shoqerise dhe do te filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise prane organeve tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 2022.

Neni 19 Balanci. Mbajtja e kontabilitetit


- 19.1 Balanci vjetor i Shoqerise shqyrtohet ne mbledhjet e Asamblese se ortakeve dhe duhet te hartohet per tju paraqitur organeve tatimore ne datat e parashikuara ne Ligj.
- 19.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe ne monedhen Shqiptare. Shoqeria mund te kete edhe llogari te vecanta ne valute.
- 19.3 Shoqeria mund te marre financime nga ortaket, institucione financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte saj. Per kete qellim shoqeria mund te jape si garanci barre mbi pjeset e kapitalit ose sende te paluajtshme, me autorizim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 20 Te ardhurat. Dividendi

- 20.1 Shoqeria do te krijojte fonde rezerve per realizimin e objektit te saj.
- 20.2 Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo ushtrimori, pas pagimit te tatimeve, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 21 Likuidimi

- 21.1 Shoqeria do te hyje ne procesin e likuidimit, nese:



- gjendja ekonomike ne Shqiperi nuk do te lejoje vazhdimin e veprimtarise se shoqerise;
 - Asambleja e Ortakeve vendos te prishe shoqerine.
- 21.2 Ne menyre qe te ndermarre procedurat e likujdim, Asambleja e Ortakeve emeron nje likuidator ose nje grup likuidatoresh,
- 21.3 Likuidatori/likuidatoret do te raportojne mbi gjendjen e zerave te aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise rreth operacioneve te metejshme te likuidimit dhe kohen qe nevojitet per perfundimin e tij. Ne fund te ketij procesi, Asambleja e Ortakeve shqyrton bilancin perfundimtar dhe mbylljen e procedures se likuidimit.

Neni 22

Zgjidhja e mosmarreshjeve

- 22.1 Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, palet i drejtohen per zgjidhje Arbitrazhit Tregtar prane Qendres Shqiptare per Ndermjetesim dhe Arbitrazh Tregtar.

Neni 23

Klauzola mbyltese

- 23.1 Ky statut hartohet ne 5 ekzemplare, ne gjuhen Shqipe secili me vlere te njejte ligjore.

Tirane me 08.03.2022

ORTAKET THEMELUES

DANJEL GARUNJA

Danjel Garunja

ALFRED MUHAREMI

Alfred Muharemi

ZOJE HASANAJ

Zoje Hasanaj

LESINA BEGVARFAJ

Lesina Begvarfaj

ZHYLJEN SAVA

Zhyljen Sava